

KONTRATË SHITJE



Sot më datë, 27.10.2016, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Z. Limos Malaj**, qytetar shqiptar, lindur në Tepelene, Shqipëri, me 12 Gusht 1948, banues në Rr Mihal Grameno, Pallati 10, Shk 2, Apt 25, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. 024611373 dhe nr. personal E80812070H (këtej e tutje referuar si "Shitësi");

nga njëra anë

dhe

- **Znj. Besjana Doda**, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, më 8 Dhjetor 1982, banuese në Ali Pashë Gucia, Pallati i ri Aurora Konstruksion, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 031997608 dhe nr. personal I26208150R (këtej e tutje referuar edhe si "Blerësi")

nga ana tjetër

(këtej e tutje Shitësi dhe Blerësi referohen bashkarisht edhe si "Palët" dhe veçmas si "Pala")

Kushtet paraprake

- A) Shitësi është pronar i një kuote të barabartë me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë të së drejtës shqiptare BDO Albania Sh.p.k., me seli në adresën Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri, me NUIS L02407004C, (këtej e tutje referuar edhe si "Shoqëria");
- B) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit një pjesë të kuotës së kapitalit që ai zotëron në Shoqëri, të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- C) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi një pjesë të kuotës së kapitalit të Shoqërisë, të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë Shitje (këtej e tutje referuar si "Kontrata") sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë pjesë përbërëse dhe thelbësore të Kontratës.

Neni 2 Shitja e kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi shet dhe transferon një pjesë nga kuota që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 10% (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (këtej e tutje referuar si "Kuota"), të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen.
- 2.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ortakut në Shoqëri, dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e Shoqërisë duke filluar nga viti ushtrimor në vazhdim, për të ndarë pasurinë e Shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme.



Me transferimin e Kuotës sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i ndarë midis dy prej ortakëve të Shoqërisë, të cilët kanë cilësinë e Shitësit dhe Blerësit në këtë Kontratë, si më poshtë:

- Z. Limos Malaj, i përket një kuotë e barabartë me 20% (njëzet për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- Znj. Besjana Doda, i përket një kuotë e barabartë me 10% (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 3 Çmimi

Shitja e Kuotës parashikuar në nenin 2.1 më sipër kryhet dhe pranohet për çmimin e deklaruar dhe pranuar nga Palët në vlerën nominale të Kuotës prej 83,800 (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind) Lekë, çmim i cili është paguar nga Blerësi njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Neni 4 Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Blerësi deklaron se futet në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet, duke deklaruar se e njeh më së miri dhe se e çliron Shitësin nga çdo lloj pasivi të Shoqërisë, si aktual ashtu edhe potencial, që ekziston deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në lidhje me Kuotën e Shoqërisë e cila transferohet tek Blerësi.

Neni 5 Shpenzimet

Shpenzimet ligjore në lidhje me këtë Kontratë do të jenë në ngarkim të Blerësit.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.
- 6.2 Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet ekskluzivisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7 Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Palëve.

Neni 8 Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 9



Origjinalet

Kjo kontratë është lidhur në 4 (katër) origjinalet në gjuhën shqipe.

Kjo kontratë nënshkruhet nga Palët në Tiranë, më datë 27 Tetor 2016.

Z. Limos Malaj

LIMOS MALAJ

SHITËSI

Znj. Besjana Doda

Besjana Doda

BLERËSI



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
SHKËRTIM I IDENTITETIT

Doda
Emri i plotë
Besiana
Emri i familjes
Shqiptare/Albanian
Emri i shtetësisë

Tirane
Emri i bashkisë

08-12-1982
Data e lindjes
12-11-2012
Data e emërimit


031997608
Numri i identifikimit


F
Lloji i identifikimit

11-11-2022
Data e skadencës së identifikimit

I26208150R
Numri i shtetësisë

ME





REPUBLIKA E SHQIPRIE

Malaj
Emri i shtetshqiptar

Limos
Emri i shtetshqiptar

Shqiptare/Albanian
Emri i shtetshqiptar

Tepelene
Emri i shtetshqiptar

12-08-1948
Data e lindjes

18-03-2009
Data e marrjes se shtetshqiptarise

MB
Autoriteti i shtetshqiptarise


024611373
Numri i shtetshqiptarise

M
Lloji i shtetshqiptarise

17-03-2019
Data e shtetshqiptarise

E80812070H
Numri i shtetshqiptarise

Limos



VERTETIM

Sot me date 27.10.2016 (dymijegjashtembedhete) para meje Noter Publik Alket B. SKENDAJ me Seli: Rr.“Reshit COLLAKU”, Pall.“SHALLVARE”, Nr.11 Tirane u paraqit personalisht dhe me kerkoi vertetimin noterial te nenshkrimit ne kete Dokument, te perpiluar prej tyre jashte kesaj Zyre Noteriale si me poshte:

-Limos Mehmet MALAJ, lindur me 12.08.1948 ne Tepelene dhe me banim ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID Nr.Personal E80812070H date 18.03.2009, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

-Besjana Limos DODA, lindur me 08.12.1982 ne Tirane dhe me banim ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID Nr.Personal I26208150R date 12.11.2012, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Sa me larte mbasi u binda per identitetin si dhe per nenshkrimin e vullnetshem ne kete Dokument sipas deklarimit ne kete Zyre Noteriale, me pas une Noteri Publik i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.7829 date 01.06.1994 “Per Noterine”.

NOTER

Alket B. SKENDAJ